



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prinijeno/Prodato Received/Delivery	14.01.2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSTICK	149/2021		1:1:4



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.nr.403/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, dhe Avdyll Bektashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.403/2020 të datës 08.12.2020 të parashtruar nga ankuesit:

dhe të cilët me autorizim i përfaqëson Avokati me adresë Rr."Dr.Bajram Krasniqi", nr.7 në Podujevë, kundër organit të punësimit Komuna e Malishevës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 dhe 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur më datën 14.01.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Hedhet poshtë si e pa lejuar ankesa me numër A.nr.403/2020 e datës 08.12.2020 e parashtruar nga ankuesit
- II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit dhe të parashtruar përmes ankesës A.nr.403/2020 të datës 08.12.2020.

**A r s y e t i m**

Ankuesit,

dhe që të gjithë punëtorë të Komunës së Malishevës, përmes përfaqësuesit të autorizuar Avokatit me datë 08.12.2020 përmes postës kanë parashtruar ankesë me numër protokolli 3011/2020 të regjistruar me numër A.nr.403/2020, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 15.12.2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Malishevës, ndërsa me datë 05.01.2021, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Malishevës, se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

*Kolegj për Shqyrtimin e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, si dhe vendosjes në mënyrë meritore të çështjes, ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokolli 3011/2020 të datës 08.12.2020 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 18.02.2020; Listën me nënshkrim të punëtorëve të administratës së Komunës së Malishevës; Akt Emërimit e datës 10.03.2014 dhe ID identifikues të R.K; Akt Emërimit e datës 24.01.2012 dhe ID identifikuese të V.M; Akt Emërimit e datës 24.01.2012 dhe ID identifikuese të XH.M; Akt Emërimit e datës 24.01.2012 dhe ID identifikuese të Z.K; Akt Emërimit e datës 25.01.2012 dhe ID identifikuese të D.K; Akt Emërimit e datës 08.10.2012 dhe ID identifikuese të E.K; Aktvendimin e datës 05.02.2018 dhe ID identifikuese për M.M; Akt Emërimit e datës 04.01.2012 dhe ID identifikuese të A.K; Akt Emërimit e datës 04.01.2012 dhe ID identifikuese të F.B; Akt Emërimit e datës 25.01.2012 dhe ID identifikuese të H.K; Akt Emërimit e datës 25.01.2012 dhe ID identifikuese të M.M; Akt Emërimit e datës 07.09.2015 dhe ID identifikuese të N.B; Vendimin me Nr.01/1427 të datës 27.11.2019 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr.01/1489 i datës 27.11.2019 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr.01/1484 i datës 27.11.2019 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr.01/1483 i datës 27.11.2019 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr.01/1482 i datës 27.11.2019 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr.01/1481 i datës 27.11.2019 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr.01/1471 i datës 27.11.2019 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr.01/1470 i datës 27.11.2019 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr.01/1469 i datës 27.11.2019 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr.01/1466 i datës 27.11.2019 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr.01/141348 i datës 10.12.2020 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr.01/1297 i datës 07.12.2020 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr.01/1299 i datës 07.12.2020 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr.01/1300 i datës 07.12.2020 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr.01/1301 i datës 07.12.2020 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr. 01/1264 i datës 07.12.2020 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr.01/1263 i datës 07.12.2020 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr.01/1262 i datës 07.12.2020 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Listat e pagave dhjetor 2019 dhe dhjetor 2020; Vendimin me Nr.01./918 i datës 16.09.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Malishevës; Ankesën e ankuesve e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Malishevës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e bashkangjitura të lëndës, të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa A.nr.403/2020 e datës 08.12.2020, e parashtruar nga ankuesit

*Ihe*

*është e pa lejuar, sepse:*

Ankuesit me datë 08.12.2020 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin që t'iu njihet e drejta për kompensimin e pagës së trembëdhjetë (13) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, Pagesën përcjellëse me rastin e

pensionimit në lartësi të tri pagave mujore; Pagesën për shpërblim jubilar; si dhe pagesën për ushqim ditor për ditët e pranisë në punë, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, si dhe Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në shkresat e lëndës, ka gjetur se ankuesit janë të punësuar në Komunën e Malishevës, të cilët me datë 18.02.2020 i janë drejtuar me kërkesë Drejtorisë për Buxhet dhe Financa si dhe Zyrës së Personelit në Komunën e Malishevës, për njohje të të drejtave të pretenduara si në ankesë, por siç deklarojnë, asnjëherë nuk kanë pranuar ndonjë përgjigje lidhur me kërkesën e tyre. Ndërsa me datë 30.06.2020, ankuesit përmes përfaqësuesit të autorizuar Avokatit kanë parashtruar ankesë, me bazë të njëjtë, në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Malishevës. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Malishevës më datë 16.09.2020 ka nxjerr Vendim me Nr.01/918 me të cilin është shpall jo kompetent për shqyrtimin e ankesës të ankuesve.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave, bazuar në nenin 50 paragrafi 1, dhe nenin 81 paragrafi 2 nen paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, i cili ka qenë i aplikueshëm deri me datë 09.07.2020, si dhe nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil. Ndërsa Ligji Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 127 përcakton se: *1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ; 2. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.*

Andaj, duke u bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht deklarimin e ankuesve se me datë 18.02.2020 i janë drejtuar me kërkesë Drejtorisë për Buxhet dhe Financa si dhe Zyrës së Personelit në Komunën e Malishevës, për njohjen e të drejtave të pretenduara si në ankesë, Ankesën e datës 30.06.2020 të parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i ankuesve në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave pran Komunës së Malishevës, si dhe Vendimin Nr.01/918 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me të cilin është shpall jo kompetent për shqyrtimin e ankesës të ankuesve, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, vlerëson se ushtrimi i ankesës me datë 08.12.2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke u bazuar në nenin 129 paragrafi 1 nen paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në piken 1 të këtij vendimi.

Ndërsa, lidhur me ankesën e ankuesit \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_  
Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur, *sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke i'u referuar shkresave të lëndës, respektivisht Aktvendimit të datës 05.02.2018, ka konstatuar se ankuesi \_\_\_\_\_ është i emëruar në pozitën e Drejtorit të Drejtorisë për Shërbime Publike në Komunën e Malishevës, e cila pozitë nuk





është pozitë e nëpunësit civil por është pozitën e funksionarit publik siç parashihet me nenin 3 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Ndërsa ankuesit dhe në bazë të provave të lëndës mbajnë pozitën e punës Roje Pylli në Komunën e Malishevës, andaj te njëjtit nuk e kanë statusin e nëpunësit civil, por statusin e nëpunësit administrativo-teknik - dhe mbështetës, siç parashihet me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 2 paragrafit 6 ku përcaktohet se: *Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike.*

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të vendosur vetëm për nëpunësit civil dhe kandidatet për pranim në Shërbimin civil, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në pikën 2 të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.403/2020

**Avdyl Bektëshi**

*per*  
Procesmbajtës

**Jeton Koca**

Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit të autorizuar, avokatit
- Kryetarit të Komunës së Malishevës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Malishevë ;
- Arkivit të KPMSHCK-së

